


14-11-2017


NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ –Departamenti për krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Musa Konxheli, me asistentin Muedin Rexhepi në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.Lnr.107/2017 të datës 11 gusht 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurorit të shtetit Arben Ismajli, të akuzuarit [REDAKTUAR], me dt: 29.09.2017, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rr'' [REDAKTUAR]', i lindur me [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], gjendjes së mesme ekonomike, tregtar, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datën 16.06.2017 rreth orës 11:00 në Ferizaj në rr''Migjeni'', ka poseduar armët në kundërshtim me nen 5 të ligjit për armë numër 05/L-022, në atë mënyrë që pas një kontrolli në shtëpinë e tij iu është gjetur arma-pistoletë me gas Ekol Jaskal Dual Kompakt me numër serik 1640122, e cila iu është sekuestruar nga policia.

me të cilën ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 374 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, dhe 83 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPK-ës, i

SHQIPTON

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300/ TREQIND/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma-pistoletë me gas Ekol Jaskal Dual Kompakt me numër serik 1640122.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjetë/€, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën të evidentuar si PP/I.nr. 107/17 të dt. 11 gusht 2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29 shtator 2017, në të cilën shqyrtim fillestar i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin për veprën penale të kryer si dhe duke premtuar se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.

Prokurori i Shtetit Arben Ismajli, duke paraqitur mendimin e saj përkritazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh mendimin e Prokurorit të Shtetit, deklarimit të pandehurit, shqyrtoi me kujdes faktet e përcaktuara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i datës 16.12.2016 si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, meqë me

datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuari me dashje direkte ka kryer veprën për të cilën akuzohet.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale përkatësisht që në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke shprehur shkallë të lartë reale dhe të sinqertë të pendimit për veprat penale të kryera (e shprehur edhe në seancën e shqyrtimit fillestar), se deri më tani nuk rezultoi të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat veçanërisht lehtësuese, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori parasyshë mendimin e prokurorit të shtetit, të të pandehurit dhe konform dispozitës së nenit 75 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së që të shqiptohet një dënim nën minimumin e përcaktuar me ligj dhe vlerëson se bazuar në rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale është e justifikueshme që të shqiptohet dënim nën minimumin ligjor, përkatësisht Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi (nën minimumin e përcaktuar ligjor) është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma-pistoletë me gas Ekol Jaskal Dual Kompakt me numër serik 1640122.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30/tridhjetë/€, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME
TË RËNDA, PKR.nr. 125/17, me datë 29.09.2017.**

Asistenti

Muedin Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues,

Musa Konxheli



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.